

PROKURORA DIBËR

Adresa:

331 dt 09.04.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1482
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 09/04/2026

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.14

Datë: 07.04.2026 si dhe projekt-vendimin nr.05 Datë 17.03.2026.

“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2027-2030 TË BASHKISË DIBËR”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi





1482/10/04/26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBER

Nr.331/1 prot.

Peshkopi, më 04.04.2026

Lënda : Për vendimin nr.14, datë 07.04.2026 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR
BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.14, datë 07.04.2026 “**Për miratimin e Planit Social 2027-2030 të Bashkisë Dibër**”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi të bazueshmërisë ligjore, në kushtet e respektimit të kuadrit ligjor përkatës, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë që paraqesin per miratim projekt-aktin.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 14 Datë 07 / 04 / 2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2027-2030 TË BASHKISË DIBËR”


Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 24, në ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenet 36,45 VKM nr.111 datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, VKM nr.150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social shoqëror”, Sektori i Kujdesit Social në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore, për Planin Social 2027-2030 të Bashkisë Diber dhe me propozim të tyre, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.04.2026**, me 16 pro, 0 kundër dhe 2 abstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Social 2027-2030 të Bashkisë Diber.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Kujdesit Social, Bashkia Diber.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.
4. Vendimi u shpall me datë **07.04.2026**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 05 datë 17/03/2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2027-2030 TË BASHKISË DIBËR”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenet 36, 45, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, Sektori i Kujdesit Social në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore, për Planin Social 2027-2030 të Bashkisë Dibër. Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Dibër:

1. Miratimin e Planit Social 2027-2029 të Bashkisë Dibër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Drejtori i Kujdesit Social

Fatjon Ademi

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi

Drejtori Ekonomik

Çeljeta Zuna

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM

ZV/KRYETARI

Lorenc Cibaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

DREJTUAR:MINISTRIA E SHËNDETSISË DHE E MIRËQENIES SOCIALE

PLAN SOCIAL

PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQEROR

PERIUDHA:36 MUAJ (2027-2029)

PERGATITUR NGA:BASHKIA DIBERSEKTORI PERGJEGJES :DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

Kryetari i Bashkisë

Rahim SPAHIU



Drejtori i Kujdesit Social

Fatjon ADEMI

PROJEKT PROPOZIM
NGRITJA E QENDRES KOMUNITARE SHUMËDISIPLINORE (QKSHD)
BASHKIA DIBËR

Institucioni propozues: Bashkia Dibër

Institucioni financues: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Kohëzgjatja: 36 muaj (2027–2029)

Fondi i kërkuar:

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bashkia Dibër përballet me sfida të rëndësishme sociale që lidhen me varfërinë, migracionin, papunësinë dhe mungesën e shërbimeve komunitare për familjet dhe individët në nevojë. Aktualisht, në territorin e bashkisë mungojnë shërbime të integruara komunitare që të adresojnë në mënyrë të koordinuar nevojat e grupeve vulnerabël.

Në këtë kuadër, Bashkia Dibër propozon ngritjen e një **Qendre Komunitare Shumëdisiplinore**, e cila do të ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror në përputhje me standardet kombëtare për këtë lloj shërbimi.

Qendra do të funksionojë si një strukturë komunitare që: (i) identifikon dhe vlerëson nevojat e individëve dhe familjeve në vështirësi; (ii) ofron shërbime sociale, psikosociale dhe zhvillimore; (iii) aplikon qasjen e menaxhimit të rastit; (iv) bashkërendon shërbimet me institucionet lokale dhe organizatat e tjera

Qendra do të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe në rritjen e përfshirjes së grupeve vulnerabël në komunitet.

2. KONTEKSTI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Ky projekt bazohet në: (i) **Ligji nr. 121/2016** “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; (ii) Standardet kombëtare për **Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore** të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; (iii) **Startegjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030**.

Qendra do të funksionojë si pjesë e sistemit lokal të shërbimeve sociale dhe në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile.

3. ANALIZA E SITUATËS

Bashkia Dibër përballet me disa sfida sociale:

- numër i konsiderueshëm familjesh përfituese të ndihmës ekonomike
- të moshuar që jetojnë vetëm
- familje me fëmijë me aftësi të kufizuara
- gra kryefamiljare dhe familje në situatë të vështirë ekonomike
- raste të dhunës në familje dhe problemeve sociale të lidhura me varfërinë

Megjithëse Bashkia Dibër ka struktura të shërbimit social, mungojnë **shërbime komunitare të integruara**, që të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme dhe programe zhvillimore për këto grupe.

Ngritja e një qendre komunitare shumëdisiplinore do të mundësojë: (i) identifikimin më të mirë të rasteve në nevojë; (ii) ofrimin e shërbimeve të koordinuara që do të mundësojnë fuqizimin, mbrojtje dhe riintegrim social për individët që do të marrin shërbime në qendër; (iii) përfshirjen aktive të komunitetit në proceset sociale.

4. QËLLIMI I PROJEKTIT

Të përmirësohet mirëqenia dhe përfshirja sociale e individëve dhe familjeve në situatë vulnerabël në Bashkinë Dibër përmes ngritjes dhe funksionimit të një Qendre Komunitare Shumëdisiplinore.

5. OBJEKTIVAT SPECIFIKE

1. Të krijohet dhe të bëhet funksionale një Qendër Komunitare Shumëdisiplinore brenda vitit të parë të projektit.
2. Të ofrohen shërbime sociale dhe psikosociale për të paktën **100 përfitues në vit**.
3. Të forcohet bashkëpunimi ndërinstytucional përmes mekanizmave të referimit dhe menaxhimit të rasteve.
4. Të rritet përfshirja e komunitetit në planifikimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale.

6. GRUPET PËRFITUESE

Qendra do të ofrojë shërbime për: (i) fëmijë dhe familje në nevojë; (ii) familje përfituese të ndihmës ekonomike; (iii) gra në situata vulnerabël; (iv) të moshuar të vetmuar e në vështirësi ekonomike; (v) persona me aftësi të kufizuara.

7. MODELI I FUNKSIONIMIT TË QENDRËS

Qendra do të funksionojë sipas një modeli shumëdisiplinor dhe ndërsektorial, i cili përfshin:

7.1. Komitetin drejtues

Një strukturë koordinuese me përfaqësues nga: Bashkia Dibër; strukturat e shërbimeve sociale; institucionet arsimore dhe shëndetësore; organizatat e shoqërisë civile.

Komiteti drejtues do të monitorojë dhe mbështesë funksionimin e qendrës.

7.2. Qasja e Menaxhimit të Rastit

Qendra do të aplikojë metodologjinë e **menaxhimit të rastit**, që përfshin:

- Ndërveprimin me Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për identifikimin e rasteve në komunitet
- vlerësimin fillestar të nevojave
- hartimin e planit individual të ndërhyrjes për çdo rast që do të përfshihet në shërbimin e qendrës
- koordinimin me shërbimet e tjera sipas nevojave individuale
- monitorimin dhe rishikimin periodik të rastit.

8. SHËRBIMET QË DO TË OFROHEN

Qendra do të ofrojë një gamë shërbimesh komunitare:

1. **Shërbime parashoqërore, përfshijnë** : informim dhe orientim për shërbimet sociale; këshillim social dhe psikosocial

2. Shërbime komunitare

2.1. **Aktivitete edukative dhe zhvillimore për fëmijët e familjeve në vështirësi ekonomike:** mbështetje pas-shkollore për përmirësimin e rezultateve në mësim dhe reduktimin e braktisjes shkollore; kurse zhvillimi të aftësive bazë (lexim, shkrim, matematikë) për fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë; aktivitete edukative dhe krijuese (vizatim, art, muzikë, teatër) që stimulojnë zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve; aktivitete ndërgjegjësuese mbi të drejtat e fëmijëve, higjienën personale, jetesën e shëndetshme dhe aftësitë për jetën; aktivitete integruese për fëmijët nga familje vulnerabël për të nxitur përfshirjen dhe bashkëpunimin me bashkëmoshatarët e tyre.

2.2. **Aktivitete sociale për të moshuarit përfshijnë:**organizimin e aktiviteteve sociale dhe rekreative për të reduktuar izolimin dhe vetminë; takime dhe diskutime tematike mbi shëndetin, mirëqenien dhe jetesën aktive; aktivitete kulturore dhe komunitare (lexim, muzikë, lojëra sociale, aktivitete artizanale); organizimin e aktiviteteve ndërbreznore me fëmijët dhe të rinjtë për të nxitur solidaritetin dhe përfshirjen sociale; këshillim dhe orientim për akses në shërbime sociale, shëndetësore dhe administrative; mbështetje psikosociale për të moshuarit që jetojnë vetëm ose përballen me probleme sociale.

2.3. **Programe për fuqizimin e grave përfshijnë:**këshillim psikosocial dhe mbështetje emocionale për gratë në situata të vështira sociale; informim mbi të drejtat e grave dhe aksesin në shërbimet publike; aktivitete për zhvillimin e aftësive për jetën dhe rritjen e vetëbesimit; grupe mbështetëse për gratë për të ndarë përvoja dhe për të ndërtuar rrjete mbështetëse në komunitet; ndërmjetësim dhe referim drejt institucioneve për aftësi profesionale dhe orientim drejt mundësive për punësim ose vetëpunësim

2.4. **Terapi zhvillimi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara përfshin:**seanca fizioterapie për përmirësimin e aftësive motorike dhe funksionale; terapi logopedike për zhvillimin e të folurit dhe komunikimit; aktivitete zhvillimore dhe rehabilituese për përmirësimin e aftësive sociale dhe funksionale; këshillim dhe mbështetje për prindërit dhe familjarët mbi mënyrat e kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara; bashkëpunim dhe referim me institucionet shëndetësore dhe arsimore për sigurimin e shërbimeve të specializuara.

2.5. **Mjedis emergjence për gra viktime të dhunës në familje përfshin:**ofrimin e një ambienti të sigurt dhe konfidencial për strehim të përkohshëm emergjent; mbështetje psikosociale dhe këshillim për gratë dhe fëmijët e tyre; informim dhe orientim mbi procedurat ligjore dhe të drejtat e viktimave të dhunës; bashkëpunim dhe referim me strukturat përkatëse për mbrojtjen e viktimave, përfshirë policinë dhe shërbimet te tjera; mbështetje për planifikimin e sigurisë dhe për daljen nga situatat e dhunës; ndërmjetësim për akses në shërbime sociale, shëndetësore dhe strehim afatgjatë.

2.3. Shërbime ndërsektorale përfshijnë: referim dhe koordinim me institucionet publike; ndërmjetësim për akses në shërbime të tjera jashtë qendrës; mbështetje për integrim social dhe ekonomik.

9. STRUKTURA E PERSONELIT

Qendra do të ketë këtë strukturë të personelit:

Personel profesional

- Menaxher i qendrës (1)
- Punonjës social (2)
- Psikolog (1)
- Mësues / edukator (1)
- Animator social / punonjës komunitar (1)
- Fizioterapist (1)
- Logopedist (1)
- Infermier (1)

Personel mbështetës

- Asistent projekti (1)
- Punonjës mirëmbajtjeje / pastrimi (1)

Total: 11 persona

Personeli do të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme për të përmbushur standardet e shërbimit.

10. PLANI I ZBATIMIT

Zbatimi i projektit për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Komunitare Multifunkionale do të realizohet në mënyrë graduale gjatë tre viteve të para të funksionimit. Plani i veprimit parashikon faza të qarta organizimi, ngritjeje të kapaciteteve dhe konsolidimi të shërbimeve, me synim që qendra të fillojë ofrimin e shërbimeve për komunitetin jo më vonë se gjashtëmujori i dytë i vitit të parë.

Viti I – Ngritja e qendrës dhe fillimi i shërbimeve

Gjatë vitit të parë do të ndërmerren të gjitha hapat organizativë dhe logjistikë për ngritjen e qendrës dhe krijimin e kushteve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve. Në fazën fillestare do të realizohet përzgjedhja e ambienteve ku do të funksionojë qendra, duke siguruar që ato të jenë të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve sociale, të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe të përshtatura për zhvillimin e aktiviteteve komunitare. Pas përzgjedhjes së ambienteve do të kryhen ndërhyrjet e nevojshme për përshtatjen e tyre sipas standardeve të shërbimeve sociale.

Paralelisht me këtë proces do të realizohet mobilimi dhe pajisja e qendrës me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e saj, përfshirë hapësirat për aktivitete me fëmijët, këshillim psikosocial, terapi zhvillimi dhe aktivitete komunitare.

Një hap i rëndësishëm në këtë fazë do të jetë rekrutimi i stafit multidisiplinor të qendrës, përmes një procesi transparent dhe të bazuar në kriteret profesionale. Stafi i përzgjedhur do të trajnohet mbi standardet e shërbimeve sociale, metodologjinë e menaxhimit të rastit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Gjithashtu, gjatë vitit të parë do të ngrihet Komiteti Drejtues i qendrës, i cili do të përfshijë përfaqësues nga bashkia, strukturat e shërbimeve sociale, institucionet arsimore dhe shëndetësore si dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky komitet do të luajë një rol këshillues dhe mbështetës në orientimin strategjik dhe monitorimin e funksionimit të qendrës.

Pas përfundimit të këtyre fazave përgatitore, qendra synon të fillojë ofrimin e shërbimeve për komunitetin brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit të parë. Fillimisht do të ofrohen shërbimet bazë të këshillimit social dhe psikosocial, aktivitetet edukative për fëmijët, aktivitetet komunitare për të moshuarit dhe programet për fuqizimin e grave, ndërsa gradualisht do të aktivizohen edhe shërbimet e tjera të specializuara.

Viti II – Zgjerimi i shërbimeve dhe rritja e përfituesve

Gjatë vitit të dytë fokusi kryesor do të jetë zgjerimi dhe diversifikimi i aktiviteteve komunitare, në përputhje me nevojat e identifikuara në komunitet. Qendra do të rrisë numrin dhe llojin e aktiviteteve për fëmijët, gratë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, duke synuar përfshirjen e një numri më të madh përfituesish.

Në këtë periudhë do të punohet gjithashtu për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat vendore, institucionet arsimore dhe shëndetësore, policinë, shërbimet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky bashkëpunim do të ndihmojë në identifikimin më të mirë të rasteve në nevojë, referimin e tyre drejt shërbimeve të përshtatshme dhe koordinimin e ndërhyrjeve për secilin rast.

Viti III – Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e shërbimit

Në vitin e tretë të funksionimit, qendra do të fokusohet në konsolidimin e modelit të shërbimit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së ndërhyrjeve. Do të kryhen vlerësime periodike të shërbimeve të ofruara dhe të rezultateve të arritura për përfituesit, me qëllim identifikimin e praktikave më të mira dhe përmirësimin e mëtejshëm të punës së qendrës.

Në këtë fazë do të realizohet edhe një vlerësim i ndikimit të qendrës në komunitet, duke analizuar ndryshimet në mirëqenien sociale të përfituesve dhe rolin e qendrës në rritjen e përfshirjes sociale në komunitet.

Paralelisht, do të hartohet një plan i qëndrueshmërisë afatgjatë të qendrës, i cili do të përfshijë identifikimin e burimeve të mundshme të financimit, forcimin e partneriteteve me institucionet publike dhe organizatat e tjera, si dhe integrimin e shërbimeve të qendrës në sistemin lokal të shërbimeve sociale. Ky plan do të synojë garantimin e vazhdimësisë dhe zhvillimit të mëtejshëm të qendrës edhe pas përfundimit të fazës fillestare të projektit.

11. REZULTATET E PRITSHME

- Një qendër komunitare shumëdisiplinore funksionale në Bashkinë Dibër
- rreth **300 përfitues të mbështetur gjatë 3 viteve**
- rritje e përfshirjes sociale të grupeve vulnerabël
- forcim i mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional.

12. QËNDRUESHMËRIA

Pas përfundimit të projektit, Bashkia Dibër do të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit përmes:

- integritit të kostove në buxhetin vendor
- bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile
- përfshirjes së qendrës në sistemin lokal të shërbimeve sociale.

13. MATRICA E REZULTATEVE

REZULTATET	TREGUESIT	BURIMET E VERIFIKIMIT	SUPOZIMET
Qëllimi i përgjithshëm Përmirësimi i mirëqenies dhe përfshirjes sociale të individëve dhe familjeve në situatë vulnerabel në Bashkinë Dibër	- Rritje e numrit të individëve që përfitojnë nga shërbimet sociale komunitare - Përmirësim i aksesit në shërbime për grupet vulnerabel	Raporte të Bashkisë Dibër	Mbështetje e vazhdueshme institucionale dhe financiare për shërbimet sociale
Objektivi specifik 1 Krijimi dhe funksionalizimi i Qendrës Komunitare Shumëdisiplinore brenda vitit të parë	Qendra funksionale dhe e pajisur brenda 12 muajve	Raporte të projektit Eventi i hapjes së qendrës	Disponueshmëria e ambienteve dhe realizimi në kohë i prokurimeve
Objektivi specifik 2 Ofrimi i shërbimeve sociale dhe psikosociale për të paktën 100 përfitues në vit	- Minimumi 100 përfitues në vit - Minimumi 300 përfitues në 3 vite	Regjistri i përfituesve Raporte mujore të qendrës	Komuniteti informohet dhe referon rastet në nevojë
Objektivi specifik 3 Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional	- Minimumi 5 institucione partnere - Minimumi 30 raste të referuara në vit	Marrëveshje bashkëpunimi Raporte të menaxhimit të rasteve	Institucionet lokale bashkëpunojnë aktivisht
Rezultati 1 Qendra komunitare e ngritur dhe e pajisur	- Ambientet e përshtatura - Pajisjet e instaluar	Dokumentacioni i prokurimeve	Realizimi i investimeve sipas planit
Rezultati 2 Staf i multidisiplinor i rekrutuar dhe trajnuar	11 punonjës të rekrutuar dhe trajnuar	Kontratat e punës Raportet e trajnimeve	Disponueshmëria e stafit të kualifikuar
Rezultati 3 Shërbimet komunitare të ofruara në mënyrë të rregullt	- Aktivitete javore për fëmijë - Aktivitete javore për të moshuar - Grupe mbështetëse për gratë, shërbim për PAK, viktimat dhune që kanë marrë shërbim	Raporte aktivitetesh Lista pjesëmarrësish	Pjesëmarrje aktive e komunitetit
Rezultati 4 Sistemi i menaxhimit të rasteve funksional	Minimumi 100 raste referuara në Qendër e të menaxhuara në vit	Dosjet e rasteve Raportet e monitorimit	Bashkëpunimi me Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

BUXHETI

DETAJIMI I BUXHETIT PER VITIN 2027

Struktura			Insti.	Em.Shpenz	Ndare ne muaj												TOTALI
Gr	Tit	Kap			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
			600	Paga Aparati	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	3,435,840
			601	Sig shoq e shend Aparati	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	573,785
			602	Shpenzime op aparati	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	3,400,000
			606	Shpenzime op aparati													0
			230	Projekte inv													0
			231	Investime 2026	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	4,200,000
				Totali	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	11,609,625

DETAJIMI I BUXHETIT PER VITIN 2028

Struktura			Insti.	Em.Shpenz	Ndare ne muaj												TOTALI
Gr	Tit	Kap			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
			600	Paga Aparati	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	3,435,840
			601	Sig shoq e shend Aparati	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	573,785
			602	Shpenzime op aparati	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	3,400,000
			606	Shpenzime op aparati													0
			230	Projekte inv													0
			231	Investime 2026	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	4,200,000
				Totali	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	11,609,625

DETAJIMI I BUXHETIT PER VITIN 2029

Struktura			Insti.	Em.Shpenz	Ndare ne muaj												TOTALI
Gr	Tit	Kap			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
			600	Paga Aparati	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	286,320	3,435,840
			601	Sig shoq e shend Aparati	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	47,815	573,785
			602	Shpenzime op aparati	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	400,000	250,000	200,000	3,400,000
			606	Shpenzime op aparati												0	
			230	Projekte inv												0	
			231	Investime 2026	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	200,000	500,000	350,000	150,000	400,000	250,000	121,124	3,871,124
				Totali	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	734,135	1,234,135	934,135	694,135	1,134,135	834,135	655,259	11,280,749

DETAJIMI I BUXHETIT NE TOTAL PER TRE VITET 2027, 2028, 2029

Struktura			Insti.	Em.Shpenz	Ndare ne muaj												TOTALI
Gr	Tit	Kap			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
			600	Paga Aparati	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	858,960	10,307,620
			601	Sig shoq e shend Aparati	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	143,446	1,721,356
			602	Shpenzime op aparati	1,200,000	750,000	600,000	1,200,000	750,000	600,000	1,200,000	750,000	600,000	1,200,000	750,000	600,000	10,200,000
			606	Shpenzime op aparati	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
			230	Projekte inv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
			231	Investime 2026	1,500,000	1,050,000	600,000	1,500,000	1,050,000	600,000	1,500,000	1,050,000	550,000	1,400,000	950,000	521,124	12,271,124
				Totali	3,702,406	2,802,406	2,202,406	3,702,406	2,802,406	2,202,406	3,702,406	2,802,406	2,152,406	3,602,406	2,702,406	2,123,530	34,500,000

34,500,000

0

1. Personeli (36 muaj)

Pozicioni	Nr	Paga mujore (leka)	Muaj	Totali (leka)
Menaxher i qendrës	1		36	
Punonjës social	2		36	
Psikolog	1		36	
Mësues / edukator	1		36	
Animator social	1		36	
Fizioterapist	1		36	
Logopedist	1		36	
Infermier	1		36	
Asistent projekti	1		36	
Mirëmbajtje / pastrim	1		36	

2. Investime fillestare (Viti I)

Zëri	Shuma (leka)
------	--------------

Përshtatja e ambienteve

Mobilim (tavolina, karrige, dollapë, rafte)

Pajisje kompjuterike dhe IT

Zëri	Shuma (leke)
------	--------------

Pajisje fizioterapie dhe logopedie

Pajisje për aktivitete edukative

Totali investime:

3. Aktivitetet dhe programet sociale (3 vite)

Aktiviteti	Totali
------------	--------

Aktivitete për fëmijë (materiale)

Aktivitete për të moshuar

Programe për fuqizimin e grave

Materiale për terapi PAK

Materiale edukative dhe informuese

Totali aktivitete:

4. Trajnime dhe ngritje kapacitetesh

Zëri	Totali
------	--------

Trajnime për stafin

Workshope dhe seminare

Totali:

5. Shpenzime operative

Zëri	Totali
------	--------

Shërbime (energji, ujë, internet)

Transport dhe komunikim

Materiale zyre

Mirëmbajtje e ambienteve

Pako ushqimore/emergjenca

Totali shpenzime operative:

TOTALI I PROJEKTIT:34,500,000